



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Kuvendi i Kryeqytetit  
Skupština Glavnog Grada – Municipality of Prishtina

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

**i mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 1.9.2023,  
duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Pëllumb Bajçinovci, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri dhe Shegë Beqiri.

**Mungoi:** Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Mirsad Vitia, Bahri Gashi.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Osman Bllaca, Mimoza Sylejmani - drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiki - drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Izet Sadiku - drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Diellon Gjonbalaj - përfaqësues nga Zyra ligjore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Pëllumb Bajçinovci kryesues i komitetit, i cili paraqiti këtë

### REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti i punës i Kryetarit të Kryeqytetit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023;
3. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Plani i veprimit të menaxhmentit;
4. Propozim-vendimi për faljen tatimore për vitin tatimor 2023;
5. Propozim-vendimi për miratimin e raportit nr.14-050/01-85379/23, dt. 28.4.2023 të Komisionit profesional për verifikimin dhe vlerësimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale;
6. Propozim-vendimi për miratimin e raportit nr. 14-020/04-0171429/23, dt. 15.4.2023 të Komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit dhe të statusit të banesave në Bregun e Diellit, Fushën e Pajtit dhe në Hajvali;
7. Propozim-vendimi për miratimin e raportit nr. 14-050/01-85384/23, dt. 28.4.2023 të Komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit të pronës komunale në Zonën Industriale;

Faqe 1 nga 1

8. Propozim-vendimi për plotësim – ndryshimin e Vendimit nr. 01-462/01-134225/23, të dt. 29.6.2023, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë;
9. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shemsi (Rifat) Begollit;
10. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Alping SH.P.K;
11. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Delta Invest SHPK;
12. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për groposjen e kafshëve me sëmundje infektive në fshatin Bërinçë e Epërme në Prishtinë;
13. Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm “Mati 1”, për bllokun “A-11” në Prishtinë;
14. Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm “Prishtina e Re - Zona Perëndim”, për pjesën e banimit individual – njësitë hapësinore “I,L,G në Prishtinë;
15. Të ndryshme.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës **Izet Sadiku**, propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës “Draft-rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01.nr.110-1203, dt. 16.6.2010”.

Lidhur me këtë, Draft-rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës. Të pranishmit në pika të shkurta i informoi drejtori Izet Sadiku, duke cekur se qëllimi i kësaj rregulloreje ka të bëjë vetëm me nenin 15 që e rregullon punën e barnatoreve në kryeqytet. Arsyeja e vonës që e kam sjell sot në KPF këtë pikë me fut në rend dite është se e kemi pasur afatin deri të dielën për debatin publik dhe nuk kemi pasur mundësi ta sjellim më herët.

**Kryesuesi:-** tha se komisioni pasi i ka shikuar rekomandimet e sugjerimet që kanë qenë gjatë debatit publik, i kanë përpunuar dhe rregullorja është e gatshme për t’u proceduar në mbledhjen e ardhshme të asamblesë, në qoftë se ju jeni të pajtimit të futet si pikë e rendit të ditës.

**Izet Sadiku:** - tha se Rregullorja është nisur për interesa të qytetarëve, mirëpo gjatë bisedave dhe debateve, është dal që këtu kanë interes edhe punëtorët shëndetësorë, farmacistët, por edhe bizneset.

**Kryesuesi:** - tha nëse jeni të pajtimit mund të procedojmë dhe hapi diskutimet për këtë çështje.

**Leutrim Retkoceri:** - ia parashtrori disa pyetje drejtorit: në dëgjim publik sa qytetarë kanë marrë pjesë,- ora 21:00 me çfarë është lidhur si orë që duhet të përfundojë orari, si do të njoftohen qytetarët për këto pesë barnatore se cilat janë ato që do të punojnë.

**Izet Sadiku:** - iu përgjigj pyetjeve duke cekur se kanë qenë diku 30-40 qytetarë prezent. Sa i përket orës 21:00 që do të përfundojë orari, ka qenë komisioni, ka qenë Oda e Farmacistëve dhe barnatoreve të Kosovës, dhe ka qenë rekomandim i tyre, realisht ata thanë që 21:00 është e mjaftueshme për secilën barnatore të punojnë. Sa i përket informimit të qytetarëve ne e kemi inkorporuar Odën e Farmacistëve,

Oda do ta bëjë atë dhe do të jetë në web-faqe të komunës, ata neve na e dërgojnë dhe secila barnatore do ta ketë në derë orarin mujor se kush kujdestaron çdo natë.

**Leutrim Retkoceri:** - tha do t'ju sugjeroja diçka drejtor, e njëjta të përfshihet edhe si propozim edhe në rregullore brenda nenit 15.4, që i obligon operatorët apo barnatoret me vendos një orar, kështu si rregullore me i obliguar edhe QKMF-të edhe po supozoj emergjencën në QKUK, që me pas një orar barnatoret se cilat barnatore si e kanë orarin. Kjo ua lehtëson qytetarëve me e marrë informatën aty për aty dhe me u drejtuar të cila barnatore mund të shkojnë në cilin orar.

**Jeta Rafuna:** - pyeti se këtu te kujdestaritë, çfarë kohe do të kenë barnatoret që do të kujdestarojnë, a do të jenë mujore.

**Izet Sadiku:**- tha se varet sa i bie tani se ata kanë thënë që në fillim do të shohin se cilat barnatore dëshirojnë të jenë të lira nga kujdestaria, do të lirohen.

**Pëllumb Bajçinovci, kryesues:** - tha orari dhe kalendari mujor apo javor, cilat barnatore pozicioni, numri i telefonit dhe adresa me qenë më e detajuar sepse kush nuk e di se ku është barnatorja, ose kontakton me telefon ose e sheh adresën e saktë.

**Milazim Vitija:** - tha sa i përket tri Qendrave të Mjekësisë Familjare që kujdestarojnë gjatë natës, duhet me qenë një orar aty që kujdestare do të jenë këto barnatore, me pas një orar mujor se cilat barnatore do të jenë kujdestare gjatë këtij muaji që kur të dalin ata e shohin aty njoftimin.

**Izet Sadiku:** - tha do të jenë të gjithat edhe në rrjetet sociale, këto që janë në kujdestari do ta kenë detyrimisht.

**Diellon Gjonbalaj:** - tha sa i përket propozimit të Leutrimit, mendoj që është Rregullorja për Organizatat e Biznesit dhe me këtë rregullore nuk mund ta obligojmë QKMF-në për të vendosur diçka sepse vlen vetëm për subjekte afariste. Kështu që siç tha drejtori, mundet Drejtoria e Shëndetësisë në koordinim me QKMF-në dhe QMF-të tjera për të publikuar orarin e kujdestarisë.

**Izet Sadiku:** - tha se barnatoret mund t'i detyrojmë për ta publikuar.

**Shegë Beqiri:** - tha se barnatoret do të hezitojnë që ta publikojnë atë orar sepse i bie që i reklamon konkurrentët e vet.

**Kryesuesi:** - e hodhi në votim propozimin e Izet Sadikut "Draft-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01.nr.110-1203, dt. 16.6.2010" që të futet si pikë në rend dite.

### **Njëzëri u miratua propozimi i drejtorit Izet Sadiku që të futet si pikë e rendit të ditës.**

**Leutrim Retkoceri:** - propozoj të futet si pikë e rendit të ditës, formimi i Komisionit për draftimin e Kodit të etikës për anëtarët e Kuvendit Komunal të Kryeqytetit. Jam konsultuar dhe qëndron edhe nga ana ligjore iniciativa, qëndron edhe për nga ana e nevojës dhe e rasteve.

**Arbër Sadiki:** - tha se edhe nëpër ndërmarrje publike kemi rregullore të etikës, kështu që pse mos ta ketë edhe Kuvendi.

**Leutrim Retkoceri:** - tha kjo i ndihmon institucionit me e rritë besueshmërinë, kredibilitetin dhe imazhin para qytetarëve, kështu që kjo është ideja, së pari duhet të formohet komisioni dhe të gjitha

grupet me i sjellë rekomandimet, kërkesat dhe propozimet që i kanë, pastaj në seancën tjetër besoj që ka kohë mjaftueshëm që të jetë gati të votohet Kodi i etikës.

**Kryesuesi:** - e hodhi në votim propozimin e Leutrim Retkocerit “**Propozim-vendimi për formimin e Komisionit për hartimin e Kodit të etikës, për anëtarët e Kuvendit Komunal të Prishtinës** që të hyjë si pikë në rend dite.

**Njëzëri u miratua propozimi i Leutrim Retkocerit që të futet si pikë e rendit të ditës.**

**Leutrim Retkoceri:**- ceku që është diskutuar për një propozim për vendosjen e një lokacioni që është kthyer prej Ministrisë për një pllakë për protestat e vitit 81, “Pranvera Shqiptare 81”. Ajo është kthyer dhe unë propozoj që e njëjta të përgatitet me materiale dhe të vjen në seancën e radhës, është mirë të procedohet sepse arsyetimi i Ministrisë është që nuk është e paraparë në PZHK dhe janë disa gjetje të tjera teknike, ato tekniket mund të përmirësohen si propozim.

**Mimoza Sylejmani:** - tha në fund të shtatorit do të jetë edhe një seancë dhe propozoj që atëherë të futet kjo çështje në mënyrë që të kemi më shumë material.

**Leutrim Retkoceri:** - tha, drejtoreshë vetëm merre përsipër që në shtator të jetë gati si material.

**Jeta Rafuna:**- tha se për pikën e 12 **Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për grosposjen e kafshëve me sëmundje infektive në fshatin Bërincë e Epërme në Prishtinë**, kërkoi që dikush nga Drejtoria e Pronës të na jep më shumë detaje se si e kanë përzgjedhur atë pronë sepse është afër banimit të njerëzve. Desha të pyes se a keni informata për këtë pikë nëse nuk keni informata të tërhiqet kjo pikë. Lidhur më këtë pikë dha sqarime Mimoza Sylejmani, drejtoresha.

**Arbër Sadiki:** - tha se drejtoresha Mimoza veçse e tha, realisht ai komision që është caktuar të merret me atë punë, i kanë marrë parasysh këto, tani ne nuk mund ta paragjykojmë ekspertizën e tyre. Ata e kanë bërë një ekspertizë dhe e kanë caktuar atë lokacion, sipas tyre kjo është paraparë si zgjidhja më e mirë.

**Mimoza Sylejmani:** - tha, nëse ka nevojë për seancë e sjellim përfaqësuesin nga mjedisi dhe e jep një sqarim tjetër dhe personat kompetentë që kanë qenë deri në fund të këtij procesi.

**Donjeta Dragusha:** - tha se tek kjo pikë nuk kemi parë ndonjë ekspertizë të bashkëngjitur përveç këtij arsyetimi që e kanë dhënë tek propozimi. Mendoj që kemi fshatra apo vendbanime pak më të largëta apo që janë më pak të banueshme për të caktuar një lokacion për këtë qëllim, kështu që pajtohemi që ndoshta përkohësisht ta largojmë dhe të shohim ndonjë lokacion më larg vendbanimeve.

**Mimoza Sylejmani:** - tha se nuk është njohëse e mjedisit, por arsyetimin si drejtori ne e bëjmë vetëm në bazë të lokacionit, kurse janë personat kompetentë si në këtë rast që është AVUK-u.

**Kryesuesi:** - tha është proces që ka zgjatur diku 1 vit e gjysmë.

**Mimoza Sylejmani:** - tha ju kisha lutur që ta fusim në seancë, e mandej nëse ka nevojë i thërrasim në seancë personat kompetentë, qoftë edhe AVUK-un.

**Leutrim Retkoceri:** - tha nëse lokacioni nuk është i përshtatshëm, aty nuk mund të them që patjetër duhet të insistojmë në një lokacion nëse nuk është i përshtatshëm për këtë situatë. Kryesues, të gjithë drejtorët që kanë pika me patjetër duhet të jenë në Komitetin për Politikë dhe Financa, meqë deri tash

kemi funksionuar me parimin që ata drejtorë që nuk janë, me u tërhequr edhe pikat e rendit të ditës, si masë ndëshkuese.

**Mimoza Sylejmani:** - tha se prona është komunale kështu që i adresohen Drejtorisë së Planifikimit, është e mandatuar për caktim të lokacionit, prona është komunale dhe drejtoresha e pronës nuk ka pasur nevojë të jetë këtu.

**Leutrim Retkoceri:** - është dashur të jetë, nuk është ideja vetëm prona, ideja është të konfirmohet sa vendbanime janë afër këtij pozicioni, çfarë komunikime kanë pasur ata me AVUK-un, cilët ekspertë kanë dalë, a ka pëlqim mjedisor.

**Kryesuesi:**- tha pajtohem që në seancën e radhës me pas një material shitesë të detajuar lidhur me këtë propozim-vendim, do të kishte qenë mirë edhe për shkak të opinionit, qytetarëve dhe kolegëve tanë që me pas një arsyeshmëri e cila nuk e kthen këtë proces mbrapa.

**Jeta Rafuna:** - tha, pasi që do të mbahet seancë edhe në fund të shtatorit, unë propozoj që kjo pikë të tërhiqet, të përgatitet dosja komplet që para seancës së ardhshme ta dimë ne saktë se a jemi për atë pikë apo jo.

**Kryesuesi:** - e hodhi në votim propozimin e Jeta Rafunës që të tërhiqet pika e 12 nga rendi i ditës “Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për groposjen e kafshëve me sëmundje infektive në fshatin Bërinçë e Epërme në Prishtinë”.

**Njëzëri u miratua propozimi i Jetës që të tërhiqet pika e 12 nga rendi i ditës.**

**Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës me ndryshimet e bëra me futjen e 2 pikave të reja në rend dite dhe tërheqjen e një pike:**

“Draft-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01.nr.110-1203, dt. 16.6.2010.” që u fut si pikë e rendit të ditës.

“Propozim-vendimi për formimin e Komisionit për hartimin e Kodit të etikës, për anëtarët e Kuvendit Komunal të Prishtinës” që u fut si pikë e rendit të ditës dhe

“Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për groposjen e kafshëve me sëmundje infektive në fshatin Bërinçë e Epërme në Prishtinë” që u tërhiq nga rendi i ditës.

**Njëzëri u miratua rendi i ditës me futjen e dy pikave të reja në rend dite dhe tërheqjen e një pike.**

**Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit i mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Pika e dytë**

**Raporti i punës i Kryetarit të Kryeqytetit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023**

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti i punës i Kryetarit të Kryeqytetit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023 dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

**Pika e tretë**

**Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Plani i veprimit të menaxhmentit.**

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Plani i veprimit të menaxhmentit dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

**Pika e katërt**

**Propozim-vendimi për faljen tatimore për vitin tatimor 2023.**

**Leutrim Retkoceri:** - tha, sa i përket çështjes së faljes së tatimit në pronë, ne si grup jemi të interesuar dhe do ta votojmë këtë propozim, por duhet ta kemi të qartë edhe situatën e buxhetit, nga sigurohen këto mjete dhe çfarë nëse Gjykata Kushtetuese e anulon ligjin dhe çfarë do të ndodh me qytetarët e Kryeqytetit prej anës sonë si Komunë me këtë rritje të hatashme të tatimit në pronë, që është 100% deri 200% rritje, e që qytetarët janë jashtëzakonisht të frustruar me këtë situatë. Do të kishte qenë shumë me rëndësi në fund me e dëgjuar edhe Drejtoreshën e Financave se si do të bëhet falja e këtyre mjeteve, a do të bëhet falja nga mospagesa e qytetarëve, apo do të rimbursohen e do t'ju kthehen mjeteve familjeve.

**Milaim Krasniqi:** - dha sqarime lidhur me çështjet që u paraqiten nga parafolësi.

**Kryesuesi:** - pyeti se në rast se dikush ka pasur ngritje prej 200 euro, sa i falen.

**Milaim Krasniqi:** - u përgjigj, i falen vetëm 100 euro për vitin 2023.

**Donjeta Dragusha:** - tha do me thënë kemi bazë ligjore me e falur tatimin edhe pse ligji është në Kushtetuese po ashtu pyeti a e ka bërë Drejtoria e Financave ndonjë kalkulim në total se sa është impakti për buxhetin e vitit të ardhshëm.

**Milaim Krasniqi:** - dha sqarime lidhur me pyetjen e parashtruar nga parafolësja.

**Donjeta Dragusha:** - pyeti çfarë ndodh me qytetarët që nuk e kanë paguar tatimin fare, e ju kanë gjeneruar nga pak vonesat dhe ndëshkimet, a iu llogaritet falja në total të borxhit, apo stopohen ndëshkimet.

**Milaim Krasniqi:** - u përgjigj se për pjesën 2022 ajo ngarkesa që është rritur i zbritet edhe kamata edhe ndëshkimi.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për faljen tatimore për vitin tatimor 2023 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e pestë**

**Propozim-vendimi për miratimin e raportit nr.14-050/01-85379/23, dt. 28.4.2023 të Komisionit profesional për verifikimin dhe vlerësimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale.**

### **Pika e gjashtë**

**Propozim-vendimi për miratimin e raportit nr. 14-020/04-0171429/23, dt. 15.4.2023 të Komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit dhe të statusit të banesave në Bregun e Diellit, Fushën e Pajtitimit dhe në Hajvali.**

### **Pika e shtatë**

**Propozim-vendimi për miratimin e raportit nr. 14-050/01-85384/23, dt. 28.4.2023 të Komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit të pronës komunale në Zonën Industriale.**

**Jeta Rafuna:** - tha, pika e pestë, e gjashtë dhe e shtatë janë propozim-vendimet të cilat i kemi diskutuar edhe në një seancë më herët dhe i kemi miratuar disa rekomandime të tri komisioneve profesionale që janë pas formuar. Ne si grup atëherë i kemi përkrahur këto rekomandime dhe ka qenë kërkesë e jona që ato rekomandime me na ardhur në Kuvend si propozim-vendime, kështu që ne si LDK nuk kemi çfarë të diskutojmë dhe presim të votohen këto propozim-vendime.

**Leutrim Retkoceri:** - tha ne jemi duke votuar rekomandime të komisioneve profesionale, jemi duke e formalizuar një rekomandim, mirëpo formalizimi i rekomandimeve nuk do të thotë që prodhon vendim të Kuvendit Komunal sepse Kuvendi Komunal është në dy situata i obliguar, ose vendos për dhënien e pronës, ose vendos listën e pronave për dhënien në shfrytëzim, kjo është si kompetencë. Çështjen tjetër të rekomandimet, unë e kam saktësisht tek pika e gjashtë, propozoj të bëhen disa përmirësime në këtë propozim-vendim, te paragrafi nr.4 që thotë: Obligohen Ndërmarrjet Publike Banesore që të bëjnë mirëmbajtjen e blloqeve të këtyre banesave, të cilat janë të dedikuara për kategoritë e banimit social, nuk mund të obligohet Ndërmarrja Publike Banesore pa kompensim, çfarë duhet të rregullohet këtu është që Kryetari obligohet të lidhë kontratë me NPB-në për mirëmbajtjen e këtyre banesave.

**Kryesuesi:** - tha është një kontratë e re e cila është bërë në mes të Ndërmarrjes Publike Banesore dhe Drejtorisë së Investimeve Kapitale, bashkë me Kryetarin Rama, e cila i përfshin disa pikë dhe disa ndërhyrje, të cilat nuk kanë qenë më herët. Ndoshta Dielloni e ka një informatë më të hollësishme, është për mirëmbajtjen e banesave, investime në hapësira tjera kulturore, sportive të Komunës së Prishtinës.

**Diellon Gjonbalaj:** - tha se janë shumë kontrata me NPB-në, dhe për këtë kontratë nuk ka njohuri.

**Kryesuesi:** - tha kjo është kontrata e fundit.

**Leutrim Retkoceri:** - tha se pika e katër e këtyre rekomandimeve nuk ka të bëjë me kontratat e ardhshme sepse NPB-ja nuk ka kontratë për mirëmbajtjen e hyrjeve, mund të ketë kontratë për investim, renovim, zhvillim të ndonjë objekti, por jo mirëmbajtjen e hyrjeve. Për atë është mirë të përmirësohet paragrafi i 4, në tërësi të riformulohet dhe të bëhet Kryetari apo Komuna obligohet që të lidhë kontratë me NPB-në për mirëmbajtjen e këtyre banesave duhet të jetë e tillë për shkak se pastaj mund të bëhet e zbatueshme. Në situatën që është kjo mbetet dhe NPB-ja, nuk e ka obligim të shkojë ta bëjë renovimin nga ky rekomandim. Edhe një çështje tjetër të banesat është edhe paragrafi 1, pjesa e fundit e fjalisë: Duhet të analizohen të gjitha kategoritë sociale, si dhe të vlerësojmë nëse e kanë zgjidhur çështjen e banimit. Tutje pyeti se këtë çështjen e banimit kush e verifikon që e kanë të zgjidhshme?

**Kryesuesi:** tha se komisioni duhet ta verifikojë, ai komision të cilin e formon Kuvendi.

**Leutrim Retkoceri:** - tha se rekomandimet jo që janë obliguese as nuk janë obliguese për Kuvend dhe as Kuvendi nuk mund ta obligojë dikë me këto rekomandime. Aty po shkruan që pronat duhet të jepen për një vit, ne duhet ta dimë që për shembull te Zona Industriale sa do të jetë ajo shumë që caktohet për dhënien e pronave në shfrytëzim, do të kishte qenë mirë që edhe rekomandimi me e pas shumë se a është për m<sup>2</sup>, kështu që edhe çështja e çmimit kishte qenë mirë me qenë e saktësuar për shkak të transparencës para qytetarëve.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për miratimin e raportit nr.14-050/01-85379/23, dt. 28.4.2023 të Komisionit profesional për verifikimin dhe vlerësimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për miratimin e raportit nr. 14-020/04-0171429/23, dt. 15.4.2023 të Komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit dhe të statusit të banesave në Bregun e Diellit, Fushën e Pajtitimit dhe në Hajvali dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për miratimin e raportit nr. 14-050/01-85384/23, dt. 28.4.2023 të Komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit të pronës komunale në Zonën Industriale dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e tetë**

**Propozim-vendimi për plotësim – ndryshimin e Vendimit nr. 01-462/01-134225/23, të dt. 29.6.2023, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë.**

**Kryesuesi:** - tha, kjo është pikë të cilën e kemi votuar, por ka pasur nevojë për ndryshim.

**Luljeta Selimi, shefe e Shërbimit të Kuvendit:** - tha se ndryshimi ka qenë tek Zona Kadastrale, Sofali Prishtinë, kështu është dashur të jetë.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për plotësim – ndryshimin e Vendimit nr. 01-462/01-134225/23, të dt. 29.6.2023, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e nëntë**

**Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shemsi (Rifat) Begollit.**

**Arbër Sadiki:** - tha sa i përket këtij propozim-vendimi është kompetente Drejtoria e Pronës, por drejtoresha është zyrtarisht në pushim, nuk mundem detajet t'i sqaroj unë. Po ashtu tha informacionet që na i dhanë tani, sipas Departamentit të Mjedisit, vlerësimi bëhet pasi që të përcaktohet lokacioni,



njëherë duhet të caktohet lokacioni për ta marrë pëlqimin edhe nga Ministria. Në takimin tjetër do ta keni prapë materialin e njëjtë sepse ato që po i kërkoni bëhen pasi që të caktohet lokacioni.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shemsi (Rifat) Begollit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e dhjetë**

**Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Alping SH.P.K.**

#### **Pika e njëmbëdhjetë**

**Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Delta Invest SHPK.**

**Kryesuesi:** - tha të dyja janë propozim-vendime për këmbimin e pronës, kanë të bëjnë me Rrugën "A", realisht këto dy pika kanë mungesë të dokumentacionit, nuk i kanë të dyja vendimet dhe një pjesë tek prona e Delta Invest SHPK e ka edhe një gabim në m<sup>2</sup>.

Kryesuesi pyeti drejtoreshën Mimoza se a keni informatë lidhur me pikën 10 dhe 11.

**Mimoza Sylejmani:** - u përgjigj, jo nuk kemi diçka më shumë.

**Leutrim Retkoceri:** - tha edhe pika 10 dhe pika 11 si materiale kanë mangësi, kështu që duhet me ardhur të plota, përndryshe nëse nuk vijnë është e pamundur me i votuar në seancë.

**Luljeta Selimi, shefe e Shërbimit të Kuvendit:** - tha se vetëm në mungesë të m<sup>2</sup> është bërë gabimi, ka ardhur materiali nga drejtorja dhe ua përcjellim për Kuvend.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrahën:**

**Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Alping SH.P.K, dhe**

**Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Delta Invest SHPK, si dhe dërgohen në Kuvend për miratim.**

**Pika e dymbëdhjetë tërhiqet nga rendi i ditës.**

#### **Pika e trembëdhjetë**

**Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Mati 1", për bllokun "A-11" në Prishtinë**

**Mimoza Sylejmani:** - tha, ne duhet ta revidojmë planin për shkak se shkolla është e paraparë me një anë të parcelës dhe ne duhet të bëjmë revidim të asaj pjese. Për më shumë dhe në ngjarje ka qenë Drejtori i Urbanizmit, Arbëri, sepse kemi pasur disa takime me pronarët e tokave dhe me pjesën aty ku lidhet blloku "A-11".

**Arbër Sadiki:** - dha sqarime shtesë lidhur me këtë propozim-vendim.

**Leutrim Retkoceri:** - pyeti se a dihet saktë se si do të zhvillohet plani për t'u bërë shpronësimet, a do të bëhet me koficient apo me ndonjë pronë që është përreth dhe a është e garantuar kjo që për një kohë të shkurtër të realizohet.

**Arbër Sadiki:** - tha kjo është temë e cila në Prishtinë ekziston tash e 10 vite, do me thënë nuk është asgjë jashtë asaj fryme, ndarja kur është bërë atëherë nuk është marrë parasysh fare mënyra gjeometrike që është ndarë dhe është e pamundur të realizohet pa u bërë këto ndryshime.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Mati 1", për bllokun "A-11" në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

### **Pika e katërmbëdhjetë**

**Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Prishtina e Re - Zona Perëndim", për pjesën e banimit individual – njësitë hapësinore "I,L,G në Prishtinë.**

**Mimoza Sylejmani:** - tha pas shumë vështirësive të cilat i ka Drejtoria e Urbanizmit për dhënien e lejeve, me kërkesë të Drejtorisë së Urbanizmit ka ardhur kërkesa për të përgatitur një arsyetim që edhe këtë plan ta revidojmë sepse ka probleme të shumta në pjesën ku janë objektet e dedikuara për ndërtim individual.

**Arbër Sadiki:** - dha sqarime shtesë lidhur me këtë propozim-vendim.

**Leutrim Retkoceri:** - tha ju potencuat se duhet më shumë të rregullohet pjesa tekstuale e saj.

**Arbër Sadiki:** - tha po pjesa tekstuale, ne jemi mësuar tani me punuar me do grafika dhe parcela kadastrale është e ndarë kështu, parcela urbanistike i vjen përmes, gjysmën e qet këndeje e gjysmën andej dhe nuk e lejon asnjërin të ndërtojë sepse ndarjen që e ka bërë plani e ka bërë në shpërputhje me gjendjen faktike që e kanë pasur në kadastër.

**Leutrim Retkoceri:** - pyeti se cila zonë e rrugës të çon aty.

**Arbër Sadiki:** - u përgjigj, ana e djathtë që shkon për Lipjan, por ka edhe pjesë që del edhe nga ana e majtë. Nuk është iniciativë për ta ndryshuar kuptimin e destinimit, është iniciativë në kuptimin e disa gjërave teknike që e bëjnë të paimplementueshëm planin.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Prishtina e Re - Zona Perëndim", për pjesën e banimit individual – njësitë hapësinore "I,L,G në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

### **Të ndryshme**

**Leutrim Retkoceri:** - kisha thënë që Propozim-vendimi për formimin e Komisionit për hartimin e Kodit të etikës, për anëtarët e Kuvendit Komunal të Prishtinës të jetë në rend të ditës pas pikës së dytë, pas Raportit të punës së kryetarit.

**Jeta Rafuna:** - pyeti se sa anëtarë duhet t'i ketë komisioni.

**Leutrim Retkoceri:** - tha duhet të jetë sikurse te Vendimi për emërimin e Komisionit për Këshilla në bashkësi, sepse është e njëjta formulë vetëm e bëjmë për formimin të komisionit për hartimin e Kodit të etikës në bazë të kompetencës që e bëjnë edhe ligji dhe rregullorja e Kuvendit për formimin e komisionit.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:35.*

**Procesmbajtësja:**  
**Shyhrete Islami**

**Kryesues i Komitetit**  
**Pëllumb Bajçinovci**



**Faqe 1 nga 1**